



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50/2024 regjistër (JR)
Datë 11.12.2024

Vendim nr. 10 (JR)
Datë 02.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 02.02.2026, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, me funksion ndihmëse/këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 801, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Pikat 4 dhe 7 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni E, pika 2, fjalja e dytë e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28-40; neni 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar; neni 3/16, neni 41/4, nenet 42, 43 dhe neni 58, pika 1/a dhe pika 2, neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 35-40, 45-47, si dhe neni 78 të Kodit të Procedurave Administrative.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e

ankimit dhe parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Aulona Bodo (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion ndihmëse/këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo¹, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. AKSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procedurave të kryera nga grupi i punës, dërgoi raportin², në të cilin konstatoi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona M. Bodo*.

2.3. KLGj-ja, në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dokumenteve ligjore, të përzgjedhur sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLGj-së, i ka përcjellë Komisionit një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo.

3. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, si më sipër, kreu një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat konkludoi se:

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë dhe të mjaftueshëm*

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.03.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Aulona Bodo, me funksion ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Aulona M. Bodo”, deklasifikuar pjesërisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZh), me vendimin nr. {***}, datë 09.05.2024.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.04.2022, “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo”.

për pasuritë e krijuara, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] subjekti i rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues [...], në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në përfundimin të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 801, datë 19.09.2024, Komisioni vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, ndihmëse/këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë.*

II. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, duke mos qenë dakord me një pjesë të vendimmarrjes së Komisionit, atë me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës për t’i njohur statusin e magjistratit dhe për ta emëruar gjyqtare të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës, nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 801, datë 19.09.2024, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”):

“Ndryshimin e vendimit nr. 801, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si më poshtë: -- Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, në detyrën e këshilltarit ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin e saj gjyqtare e Republikës së Shqipërisë. – Për efekt të karrierës gjyqësore, vitet e ushtruara në funksionin e ndihmësit/këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë, znj. Aulona Bodo i njihen si vite të ushtrimit të detyrës së magjistratit, profili “gjyqtar””.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit 58, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë në një pjesë të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe (*ratione temporis*), pasi ankimi

është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për shqyrtimin e vendimit nr. 801, datë 19.09.2024, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit, mbi bazë dokumentesh, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi të zhvilluar në datën 02.02.2026.
9. Në parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), të depozituara në Kolegj në datën 28.01.2026, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me prani të palëve, sipas parashikimit të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e këtij ligji. Kjo dispozitë ligjore, sipas subjektit, gjen zbatim, në kushtet kur në ankim janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me moskryerjen nga Komisioni të një hetimit të plotë e të gjithashëm të çështjes objekt shqyrtimi, si dhe mospërcaktimin e qartë dhe të saktë të fakteve dhe rrethanave të saj.
10. Në vijim të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit parashtron se në kushtet kur themeli i ankimit lidhet me interpretim të normave kushtetuese dhe ligjore, dhe kjo përbën praktikën e vetme gjyqësore të këtij procesi, Kolegji është organi i vetëm kompetent që ka juridiksion dhe kompetencë lëndore për të interpretuar në mënyrë shteruese dispozitat kalimtare dhe të fundit të Kushtetutës (pjesa e tetëmbëdhjetë), si dhe Aneksit të saj, të cilët janë shterues në zbatim dhe i pushojnë efektet e tyre ligjore me përfundimin e procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 179/b, pika 9 e Kushtetutës. Çështjet thelbësore të adresuara për zgjidhje në ankim janë të tilla që i kapërcejnë kufijtë e një gjykimi të zakonshëm, mbi bazë aktesh, në dhomë këshillimi. Subjekti i rivlerësimit synon të realizojë dhe të mbrojë një të drejtë subjektive personale, të cilën pretendon se i njihet dhe garantohet nga ligji dhe Kushtetuta dhe se kjo çështje ka karakter *inter partes*.
11. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji ka përgjegjësi kushtetuese që nëpërmjet vendimmarrjes së tij të interpretojë kornizën ligjore që normon procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve, ndihmësve/këshilltarëve ligjore në qasje të plotë me qëllimin dhe frymën e kushtetutëbërësit. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2/2017, ndër të tjera, është shprehur se: “[...], duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën [...]. Vendimet e Kolegjit bazohen dhe interpretojnë kuadrin ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë në përputhje me hierarkinë e akteve normative, të përcaktuara në nenin 116 të Kushtetutës”. Po ashtu, në situatën kur subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar prova të reja me ankimin, por i ngre pretendimet mbi aktet e administruara tashmë nga Komisioni në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vlerëson se nuk gjen zbatim neni 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të legjitimuar debatin gjyqësor dhe kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë

gjyqësore publike, për rrjedhojë vijoi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit

12. Komisioni, në vendimin nr. 801, datë 19.09.2024, lidhur me kërkesën për emërimin si gjyqtare, ka arsyetuar se *subjekti i rivlerësimit kryen detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës së Lartë, marrëdhënie e pandërprerë që në vitin 2014, kur është emëruar si ndihmëse ligjore nga ana e kësaj gjykate. Në kushtet kur ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është kryer procesi i rivlerësimit si ish-ndihmëse/këshilltare ligjore, por si subjekt në detyrë, nuk gjejnë zbatim dispozitat kushtetuese dhe ligjore, që janë neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për sa kohë subjekti e ushtron këtë detyrë prej kohës dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit si subjekt ex officio dhe jo me kërkesën e saj, si ish-ndihmëse/këshilltare ligjore, pavarësisht faktit se ajo e ka kaluar me sukses këtë proces rivlerësimi kalimtar për të tria kriteret e vlerësimit, në përfundim të këtij procesi ndaj saj nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 58/2 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, Komisioni e refuzoi këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, duke vendosur mospranimin e saj, për shkak të statusit aktual të subjektit të rivlerësimit [...] ndihmësit/këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, që prej vitit 2014 e në vazhdim.*
13. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar kur në përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar i ka refuzuar kërkesën për njohjen e statusit të magjistratit dhe emërimin gjyqtare. Ky konkluzion i gabuar i Komisionit, sipas subjektit në ankim, në mënyrë të përmbledhur, vjen për këto arsye:
 - 13.1. Komisioni nuk ka hetuar dhe nuk ka analizuar: (i) kriteret/kuadrin ligjor në fuqi në kohën që subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë; (ii) detyrat funksionale që përfshin pozicioni i punës së ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë; (iii) provat shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me qëllim provueshmërinë e aftësive profesionale, para dhe pas marrjes së kësaj detyre.
 - 13.2. Komisioni nuk ka interpretuar dhe analizuar qëllimin e ligjvënësit, që ndihmësit ligjor/këshilltarët ligjorë të Gjykatës së Lartë janë bërë subjekte rivlerësimi *ex officio* dhe i janë nënshtruar procesit rivlerësimit kalimtar njëlloj si edhe subjektet që ushtrojnë detyrën e gjyqtarit apo të prokurorit.
 - 13.3. Komisioni ka refuzuar të interpretojë dhe aplikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimet e nenit 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës, duke mos ushtruar kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe nuk ka bërë një interpretim pajtues të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me këtë dispozitë kushtetuese.
 - 13.4. Komisioni ka bërë një interpretim të ngushtë dhe literal të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Vendosja e subjekteve, *ex officio*, në pozita të pabarabarta në përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, bie ndesh me frymën dhe hierarkinë e normës kushtetuese, neni 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës. Diferencimi mes ish-këshilltarëve ligjorë dhe këshilltarëve aktualë nuk justifikohet nga logjika juridike dhe as nga qëllimi i ligjit për kryerjen e procesit të rivlerësimit.
 - 13.5. Komisioni ka cenuar në mënyrë të paarsyeshme sigurinë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme, për të cilat subjektet e rivlerësimit, *ex officio*, i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Arsyetimi i Komisionit, për refuzimin e kërkesës së subjektit pasi ka kaluar me sukses

procesin e rivlerësimit, është i përciptë, diskriminues, rrjedhojë e moskuptimit dhe mosinterpretimit të drejtë të normave kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme.

14. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, si dhe procesit të rivlerësimit kalimtar që i është nënshtruar subjekti në Komision, konstaton si vijon.

14.1. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 31.10.2014, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është emëruar në detyrën e ndihmëses ligjore pranë anëtares së Gjykatës së Lartë, znj. E. Q.. Me urdhrin nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, znj. Aulona Bodo lirohet nga detyra e ndihmëses ligjore, pasi kishte përfunduar afati i kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtares së kësaj gjykate, pranë të cilës ka punuar si ndihmëse ligjore. Më datë 15.09.2017, kur përfundonin dhe marrëdhëniet financiare, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin nr. {***}, datë 15.09.2017, për emërimin e znj. Aulona Bodo në pozicionin e këshilltarit ligjor në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me afat kohor të caktuar prej 3 (tre) muajsh, nga data 15.09.2017 deri më datë 15.12.2017. Pas kalimit të këtij afati znj. Bodo ka vijuar të mbajë të njëjtën detyrë.

14.2. Subjekti i rivlerësimit gjatë vitit 2019 ka depozituar 3 (tre) kërkesa pranë KLGj-së, për përcaktimin e statusit të saj si këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë. Bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), në nenet 34 dhe 84, pika 4 e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, KLGj-ja⁴, me vendimin nr. {***}, datë 15.05.2020, “Mbi statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, të znj. Aulona Bodo”, vendosi të deklarojë pasjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, të znj. Aulona Bodo.

14.3. Sipas akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gëzuar që prej emërimit të saj në Gjykatën e Lartë statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor, pandërprerje⁵.

14.4. Në Komision, më datë 15.06.2021, u shortua trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, i cili vendosi dhe fillimin e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ, më datë 11.09.2024, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, përpos shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit, i kërkoi Komisionit konfirmimin si këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë. Për këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur në Komision, por edhe më pas në ankim, argumentet si më poshtë.

⁴ Referuar procesverbalit të përmbledhur të Mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbajtur më datë 15.05.2020, rezulton se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar testimit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës për efekt të procesit të rivlerësimit pa e kaluar pragun prej 60 % të pikëve dhe nuk ka vijuar karrierën e magjistratit.

⁵ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 10.12.2019, të Gjykatës së Lartë, drejtuar KLGj-së: [...] kalimi i znj. Bodo në datën 15.09.2017 në detyrën e këshilltares ligjore në kabinetin e kryetarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet aktit individual administrative, urdhrin nr. {***}, datë 15.09.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nuk e ka cenuar aspak statusin e saj, si nëpunëse civile gjyqësore e kësaj gjykate dhe as cilësinë e saj si subjekt ex officio rivlerësimi [...] dhe gëzon statusin e nëpunësit civil gjyqësor të Gjykatës së Lartë, në përputhje me parashikimet e neneve 34, 50 dhe 84 të ligjit nr. 98/2016. Si dhe referuar bisedimeve të Mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 15.05.2020.

14.4.1. Në momentin e emërimit në detyrën e ndihmëses ligjore më datë 04.11.2014, legjislacioni në fuqi, konkretisht neni 20 i ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikonte se: “ [...] ndihmësit ligjor përzgjidhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndërmjet juristëve që plotësojnë kushtet ligjore për t’u emëruar gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit [...]”. Kjo dispozitë lidhet në zbatim me përcaktimet në nenet 11 dhe 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kushtet për t’u emëruar gjyqtar dhe emërimin e gjyqtarit⁶.

14.4.2. Parashikimi i drejtpërdrejtë në Kushtetutë, duke i bërë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë subjekte të procesit të rivlerësimit dhe njëkohësisht subjekte kushtetues, vjen pikërisht për shkak të natyrës së punës dhe rëndësisë që ajo ka në lidhje me procesin e dhënies së drejtësisë, si dhe administrimin e saj, ndonëse këto subjekte nuk kanë pasur kompetenca vendimmarrëse. Ligjvënësi, me parashikimet e tij në Kushtetutë, nuk është mjaftuar vetëm me faktin se këto subjekte do të rivlerësohen *ex officio*, por ka shkuar edhe më tej, duke vlerësuar drejtpërdrejtë edhe se si duhet të disponojnë organet kompetente në përfundim të këtij procesi, bazuar në nenin 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës, qëndrim i reflektuar në nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se kjo dispozitë i referohet ngushtësisht subjekteve të rivlerësimit, ish-gjyqtar, ish-prokuror dhe ish-këshilltar ligjor të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, parashikimet e saj janë të vlefshme për të gjithë subjektet, *ex officio*, që mbajnë aktualisht detyrën e këshilltarit ligjor në këto gjykata, pasi ligji nuk mund të kufizojë dhe nuk mund të vërë në pozita të pabarabarta subjektet, të cilët Kushtetuta i ka vënë në të njëjtin nivel dhe pozicion, pa bërë asnjë dallim mes tyre.

14.4.3. Subjekti i rivlerësimit thekson se konfirmimi në detyrë i këshilltarëve ligjorë që ushtrojnë aktualisht këtë detyrë nuk i kushtëzon organet e rivlerësimit që në mbështetje të nenit 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës, t’u njohin atyre krahas konfirmimit në detyrë dhe statusin e magjistratit, duke i emëruar gjyqtarë apo prokurorë. Ky qëndrim vjen në përputhje të plotë si me legjislacionin aktual, ashtu edhe me legjislacionin në fuqi, kur këta subjekte janë emëruar në detyrën e këshilltarit ligjor, detyrë e cila mund të ushtrohet edhe nga subjektet që e gëzojnë statusin e magjistratit. Kushtetuta në dispozitat e saj, sipas subjektit, ka sanksionuar dy mënyra për t’u futur në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë: (i) mënyra e parë është ajo e zakonshme nëpërmjet dispozitave kushtetuese që kanë karakter të përgjithshëm dhe permanent, në zbatim të neneve 136/a dhe 148/ç të Kushtetutës, si dhe neneve 28, 29, 30, 31, 32 dhe 36 të

⁶ Neni 11 i ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, parashikon: “1. Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë me arsim të lartë juridik; c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës; ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale. 2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të emërojë deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve persona, të cilët kanë punuar më parë gjyqtarë dhe përmbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni”.

Neni 12, parashikon: “1. Gjyqtari në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 2. Gjyqtari i gjykatës për krimet e rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi: a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë; b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit; ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi. 3. Gjyqtari i gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi: a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë; b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit; ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi”.

ligjit nr. 96/2016; (ii) mënyra e dytë është mënyra e jashtëzakonshme, e cila parashikohet në nenin 179/b, pikat 4 dhe 7 të Kushtetutës, të cilat kanë karakter të posaçëm, me përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

14.4.4. Nëse ligji i ka njohur në mënyrë të shprehur Komisionit të drejtën që në përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit ndaj një ish-këshilltari ligjor ta emërojë atë gjyqtar ose prokuror do të ishte brenda logjikës së normës kushtetuese që të emërojë, në të njëjtën mënyrë, edhe këshilltarin ligjor, i cili vijon ende të ushtrojë këtë detyrë, nëse kalon me sukses këtë proces. Komisioni nuk duhet të mjaftohet vetëm me konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit kur ata ushtrojnë këtë detyrë, por të avancojnë duke iu njohur statusin e magjistratit, nëpërmjet emërimit gjyqtar ose prokuror, sipas profilin që ka subjekti i rivlerësimit. Ndërsa caktimi i detyrës për këto subjekte, pasi fitojnë statusin e magjistratit, është detyrë ekskluzive e organeve kompetente të ngarkuara me ligj që drejtojnë sistemin gjyqësor, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016, sipas kërkesave dhe nevojave të sistemit nga këto organe kompetente. Interpretimi i normave ligjore të përmendura më sipër, sipas subjektit, vjen në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve European në vitin 2019⁷, të cilët kanë rekomanduar se këshilltarët ligjorë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale pranë gjykatave më të larta të sistemit të drejtësisë dhe zhvillimit të karrierës profesionale, si dhe puna e kryer prej tyre shfaq një rëndësi të veçantë në dhënien e drejtësisë, kanë të drejtë që të avancojnë në karrierë brenda sistemit të drejtësisë, për shkak të natyrës së punës që ata kryejnë dhe pa asnjë lloj barriere arsimore të mëtejshme.

14.4.5. Përpos sa është analizuar nga KLGj-ja, si organ ndihmës në këtë proces, nuk rezulton të ketë një konkluzion të plotë dhe përfundimtar në lidhje me aftësitë organizative, etikën, angazhimin profesional dhe integritetin në ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, në përputhje me kriteret dhe standardet e parashikuara në nenin E, pika 2, fjalë e dytë e Aneksit të Kushtetutës, nenin 41, pika 4, nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe dokumentacionin e administruar, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të kryejë një vlerësim të pavarur të aftësive profesionale të saj. Në këtë drejtim, subjekti ka depozituar akte ligjore të hartuara prej saj, para emërimit si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë⁸, akte të cilat, sipas saj, Komisioni duhet t'i vlerësojë për të arritur në konkluzionin se detyrat shtetërore të ushtruara prej saj kanë kërkuar punë të kualifikuar juridike dhe që i jepnin mundësinë për të qenë jurist i nivelit të lartë, mëse e kualifikuar dhe tërësisht e aftë për të kryer detyrën e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Subjekti i rivlerësimit sqaron në vijim se të gjitha vendimet e çështjeve që janë relatuar prej saj dhe është hartuar relacioni përkatës, janë draftuar po prej saj në cilësinë e këshilltarit ligjor dhe janë kontrolluar apo korrigjuar nga gjyqtari relator dhe trupa gjyqësore. Në kushtet kur draftimi i vendimit prej saj nuk ka ndryshime thelbësore nga vendimi përfundimtar i nxjerrë nga trupa gjyqësore, vërteton dukshëm aftësitë profesionale të subjektit, për të draftuar vendime gjyqësore, në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë orientim paraprak të dhënë nga relatori apo trupa gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit vë në dispozicion të Komisionit draftvendime gjyqësore të hartuara prej saj, si dhe komunikime elektronike të mbajtura me relatoren e çështjes lidhur me to. Subjekti, gjithashtu, fton Komisionin të kryejë korrespondencë me Gjykatën e Lartë për të siguruar prova të mjaftueshme shpresore apo

⁷ Shih CCJE Opinion nr. 22 (2019), the role of Judicial Assistant, pikat 11, 12, 15, 16, 46, 47 dhe 48 të tij.

⁸ Akte të hartuara kur ka ushtruar detyrën e Përgjegjës të Sektorit në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, si dhe eksperte e nivelit të lartë në Grupin e Task Forcës së Pronave të Bregdetit etj.

opinionë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Kolegjit Civil apo edhe nga e gjithë trupa gjyqësore pranë kësaj gjykate, lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Mbatja në cilësinë e këshilltares ligjore e qëndrimeve të ndryshme nga zgjidhja që ka dhënë trupa gjyqësore tregon integritetin profesional të saj, për sa kohë opinionin e dhënë ka mjaftueshëm argumente ligjore dhe logjike që mbështesin linjën e arsytimit.

14.4.6. Subjekti i rivlerësimit i kërkon Komisionit që të marrë në analizë dhe të bëjë një interpretim origjinal të dispozitës kushtetuese, konkretisht nenit 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës, si dhe një interpretim pajtues dhe në përputhje me normën kushtetuese të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni duhet të marrë në konsideratë dhe të mbajë në vëmendje qëllimin e ligjvënësit se përse subjekte të tillë, që nuk e kanë pasur ndonjëherë statusin e magjistratit si këshilltar ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë apo Gjykatën Kushtetuese apo ish-këshilltarët e këtyre gjykatave që e kanë ushtruar këtë detyrë për tre vite, por që nuk e ushtrojnë aktualisht, t'i nënshirohen procesit të rivlerësimit për mbajtjen e një detyre, e cila nuk ka funksione vendimmarrëse gjyqësore. Nëse, sipas subjektit, qëllimi i ligjvënësit ka qenë thjesht vetëm mbajtja e kësaj detyre, përse kategoria e subjekteve të tillë, *ex officio*, që nuk kanë statusin e magjistratit dhe as detyrën e gjyqtarit dhe të prokurorit, duhet të ngriheshin dhe të barazoheshin në të njëjtën nivel kushtetues me gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës, kur verifikimi i tri kriterëve mund të bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të cilët janë organe kushtetuese që japin garanci të plota për kryerjen e këtij procesi brenda standardit të përcaktuar në Kushtetutë.

14.4.7. Përfundimisht, bazuar në nenin 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës dhe në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit konfirmimin në detyrën e këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë.

15. Trupi gjyqësor i Kolegjit, pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe legjislacionin e zbatueshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar, konstaton dhe vlerëson si vijon.

15.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, në kategorinë e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pika 4, fjalia e parë e Kushtetutës, që parashikon se: *“Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio”*. Bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, *“Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe (b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”*.

15.2. Kushtetuta, në nenin 179/b, pika 7, parashikon: *“Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit”*. Subjekti i rivlerësimit pretendon se fjalia e fundit e kësaj dispozite kushtetuese duhet interpretuar së bashku me nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *“Në rast se subjektet e*

rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë: a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve; b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

15.3. Trupi gjykues konstaton se fjalia e fundit e nenit 179/b, pika 7, e Kushtetutës, u referohet subjekteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, që përfshin këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme, si dhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët dhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Këto subjekte, të cilat kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, *sipas ligjit*. Ky kriter përcaktohet si në fjalinë e fundit të nenit 179/b, pika 7, të Kushtetutës, ashtu edhe në nenin 58, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, që kërkon emërimin/refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e ligjit për statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Si për kategorinë e subjekteve të rivlerësimit, këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ashtu edhe për ish-këshilltarin ligjor pranë këtyre gjykatave, ligji nr. 96/2016, në nenin 165, pikat 4, 5 dhe 6, parashikon se këta subjekte, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të ndjekin programin teorik njëvjeçar, programin e trajnimit për një vit, për të kryer praktikën profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme dhe në përfundim të procedurave ligjore të emërohen si magjistratë, sipas parashikimeve të këtij ligji, praktikë e aplikuar ndaj këshilltarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë të emëruar tashmë gjyqtarë.

15.4. Trupi gjykues thekson se, si në rastin e këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ashtu edhe në rastin e ish-këshilltarëve, dispozitat kushtetuese dhe ligjore interpretohen në mënyrë sistematike dhe logjike, për të arritur në konkluzionin që emërimi i tyre si gjyqtar apo prokuror vjen si rezultat i plotësimit të dy kriterëve kushtetuese/ligjore: *së pari*, kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit; dhe, *së dyti*, arrijten të paktën e 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës dhe ndjekjen e programit mësimor në këtë shkollë. Në këtë kuptim, trupi gjykues gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për trajtim të pabarabartë mes këshilltarëve/ndihmësve ligjor dhe ish-këshilltarëve/ndihmësve ligjor, duke favorizuar këta të fundit, pasi konstaton se subjekti i rivlerësimit keqinterpreton përcaktimet në nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në raport me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

15.5. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar këtij procesi si ndihmëse/këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë dhe Komisioni ka vlerësuar kriterin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore për këtë kategori. Komisioni, brenda kompetencave që i ka njohur kuadri ligjor i zbatueshëm i këtij procesi, disponon përfundimisht me konfirmimin/shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit në detyrën që ata kanë ushtruar në momentin e miratimit të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligjit nr. 84/2016. Interpretimi i fragmentizuar i dispozitave që përdor subjekti vlerësohet se nuk i jep zgjidhje ankimit të saj, i cili u shqyrtua mbi analizën e të gjithë kuadrit ligjor të zbatueshëm, si më sipëranalizuar.

15.6. Në këtë kontekst, kërkimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, sa i përket: (i)

njohjes së statusit të magjistratit; (ii) emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë; si dhe (iii) për efekt të karrierës gjyqësore, vitet e ushtruara në funksionin e ndihmësit ligjor/këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë, të njihen si vite të ushtrimit të detyrës së magjistratit, profili “gjyqtar”, nuk është ligjërisht i zbatueshëm për shkak të statusit që gëzon subjekti i rivlerësimit, znj. Aulona Bodo, si dhe dispozitave ligjore të aplikueshme.

16. Sa i përket analizimit të shkaqeve të tjera të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në ankim, kryesisht mbi kriteret/kuadrin ligjor në fuqi në kohën e emërimit në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrat funksionale të këtij pozicioni apo akteve shkresore me qëllim për provueshmërinë e aftësive të saj profesionale, trupi gjykues i çmon të panevojshëm dhe pa ndikim ligjor në vendimmarrjen e tij, lidhur me këtë çështje. Në këto kushte, në vijim të arsyetimit në këtë vendim, trupi gjykues gjen të pabazuara edhe pretendimet e subjektit mbi cenimin nga ana e Komisionit të parimit të barazisë para ligjit, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme, për të cilat subjektet i rivlerësimit, *ex officio*, të kësaj kategorie, i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar.
17. Në përfundim të sa sipërsyrtuar, trupi gjykues vlerëson se vendimi nr. 801, datë 19.09.2024, i Komisioni, është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 801, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona Bodo.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 02.02.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi